



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 22-2008
Prishtinë, 14 tetor 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Bajram Kosumi, Riza Smaka, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi dhe Džezair Murati.

Munguan:Lutfi Haziri dhe Branisllav Grbiq.

Nga stafi mbështetës i Komisionit në mbledhje ishin të pranishëm: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Ahmeti - nga KDI, Valon Hyseni - KDI, Behar Xharra - UNDP, Isabel Uribe, Faruk Hashani - UNDP, Reshit Gashi - NDI, Megun Kossiakov - OSCE, Lejla Selimi – OSCE dhe Ramadan Islami – OSCE.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITES

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 shtatorit 2008;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për avokatinë;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit;

5. Shqyrtimi i raportit lidhur me interpretimin e dispozitave të Ligjit kundër korrupsionit (raportuese S. Halimi);
6. Shqyrtimi i kërkesës për interpretimin e nenit 138 të Ligjit për trashëgiminë;
7. Përgatitjet për vizitën e Komisionit në Gjykatën e Qarkut të Pejës;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16 shtatorit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për avokatinë

Kryetari – Lidhur me shqyrtimin e propozimamendamenteve në Ligjin për avokatinë fjalën ia dha raportueses së këtij projektligji znj. Selvije Halimi që e vlerësoi punën e mirë të hartuesve të këtij projektligji me disa ndërhyrje në të.

Kryetari i falënderoi raportuesen Projektligjit dhe anëtarët e Komisionit për punën e bërë dhe filloi me shqyrtimin e amendamenteve një nga një.

Amendamentet e propozuara u miratuan nga anëtarët e pranishëm të Komisionit dhe kryetari konstatoi se Projektligji për avokatinë mund të procedohet tutje.

4. Shqyrtimi i propozim amendamenteve në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryetari – Lidhur me shqyrtimin e propozimamendamenteve në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit fjalën ia dha raportuesit të Projektligjit, z. Kolë Berisha, që në formë të shkruar i paraqiti propozimamendamentet për këtë projektligj.

Kryetari filloi me leximin e Projektligjit nen për nen dhe i pyeti anëtarët e Komisionit për vërejtjet, komentet që i kanë lidhur me këtë projektligj. Të gjithë anëtarët e Komisionit e dhanë kontributin e tyre me diskutimet rreth Projektligjit deri te neni 32 dhe u vendos që në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të vazhdohet me punën e mbetur.

5. Shqyrtimi i raportit lidhur me interpretimin e dispozitave të Ligjit kundër korrupsionit (raportuese S. Halimi)

Kryetari – Lidhur me shqyrtimin e interpretimit të dispozitave të Ligjit kundër korrupsionit e ftoi ta marrë fjalën znj Selvije Halimi që e kishte përgatitur një interpretim me shkrim për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

- *Komisioni e përkrahu këtë interpretim të dispozitës ligjore të Ligjit kundër korrupsionit.*

6. Shqyrtimi i kërkesës për interpretimin e nenit 138 të Ligjit për trashëgiminë

Kryetari i Komisionit e hodhi për shqyrtim edhe kërkesën për interpretim të nenit 138 të Ligjit për trashëgiminë. Anëtarët e Komisionit këtë çështje propozuan ta shqyrtojnë në një nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit.

7. Përgatitjet për vizitën e Komisionit në Gjykatën e Qarkut të Pejës

- Në pikën e shtatë të rendit të ditës kryetari i Komisionit i njoftoi anëtarët e Komisionit për përgatitjet që janë bërë dhe për agjendën që do ta kenë gjatë vizitës në Gjykatën e Qarkut të Pejës.

8. Të ndryshme

Kryetari në kuadër të kësaj pike i njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën e Nora Sahatçiu lidhur me letrën e bardhë për mijëvjeçarin.

Procesverbali u hartua nga stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni